



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 205/7 Prot.

Tiranë, më 30.04. 2025

V E N D I M

Nr. 98, Datë 30.04. 2025

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar², mori në shqyrtim ankesën nr. 53, datë 28.02.2025, të paraqitur nga Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European, përfaqësuar nga Kryetari i Partisë z.V.S, kundër znj. I.M, Ambasadore e Republikës së Shqipërisë në Republikën e Bullgarisë, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*etnisë*”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, pala ankuese ka paraqitur shqetësimin e saj për etiketimin e komunitetit Maqedonas në Shqipëri si “Maqedonoverior” nga Ambasadorja Shqiptare në Sofje, znj. I. M, në intervistën e saj për median Bullgare “Nova.BG”. Ambasadorja M. e ka cilësuar pakicën kombëtare Maqedonase me një terminologji që jo vetëm është e papranueshme por edhe fyese për integritetin e këtij komuniteti autokton.

Me ligjin nr.96/2017 “Për Mbrojtjen e pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, Komuniteti Maqedonas në Shqipëri ndihet zyrtarisht si “Pakica Kombëtare Maqedonase”.

Subjekti ankues ka bashkëlidhur ankesës, në cilësi prove, kopjen e linkut ku mund të aksesohet intervista në fjalë si dhe një kopje të zbardhur të intervistës por jo në gjuhën shqipe.

Ankuesi kërkon nga Komisioneri marrjen e masave që Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ambasadorja I. M, të kërkojnë falje publike për përdorimin e këtij termi që fyen Komunitetin

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

Maqedonas dhe të ndërmeren hapa për të garantuar që të mos përsëriten raste të tilla, të cilat cenojnë rëndë marrëdhënien mes Komunitetit Maqedonas dhe Institucioneve Shqiptare.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja b), të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të *“etnisë”* duke përcaktuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtetësinë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Neni 7, i LMD-së, parashikon shprehimisht: *“1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”*

Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European, është regjistruar, në bazë të vendimit nr.3669, datë 08.06.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Qëllimi dhe objektivat e kësaj partie , ndër të tjera janë:

- mbrojtja e të drejtave dhe interesave politike të popullit maqedonas të Shqipërisë;
- respektimi i të drejtave themelore të njeriut, të drejtave të popullit maqedonas në Shqipëri si dhe të minoriteteve të tjera që jetojnë në Republikën e Shqipërisë;

- dhënia e kontributit të saj për një zhvillim normal të ssoqërisë multi-etnike dhe multi-kulturore shqiptare për të vendosur shtetin e së drejtës dhe ligjit;

Pala ankuese pretendon për diskriminim të personave që janë pjesë e pakicës kombëtare Maqedonase në Shqipëri, nëpërmjet etiketimit të këtij komuniteti si “Maqedonoverior” nga Ambasadorja Shqiptare në Sofje, znj. I. M, në një intervistë të saj për median Bullgare “Nova.BG”.

Bazuar në LMD, pala ankuese/Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Evropian, në cilësinë e personit juridik, është subjekt i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe legjitimohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Neni 4, i LMD-së, përcakton se cilat janë subjektet që i nënshtrohen zbatimit të tij, si vijon: *“1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. 3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.”*

Për sa më lart, lidhur me pretendimin për diskriminim përmes termit “Maqedonoverior”, të përdorur nga ana e znj. I. M, Ambasadore e Republikës së Shqipërisë në Republikën e Bullgarisë, pala ankuese i referohet intervistës së dhënë për median Bullgare “Nova.BG”.

Lidhur me verifikimin e kontetit, përmbajtjes të bisedës së zhvilluar në intervistën në fjalë, Komisioneri ju referua linkut dhe zbardhjes së intervistës të vendosur në dispozicion nga pala ankuese.

Nga këqyrja e sa më sipër, Komisioneri vëren se, intervista e dhënë nga subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, për median Bullgare “Nova.BG”, nuk është në gjuhën shqipe dhe për pasojë, përmbajtja e bisedës së zhvilluar në këtë intervistë, nuk është e kuptueshme nga ana e Komisionerit. Për rrjedhojë dhe analizimi i përdorimit të termit të pretenduar si diskriminues nga subjekti kundër të cilëve është paraqitur ankesa gjatë intervistës nuk është i mundur që të bëhet.

Me shkresat nr.205/4 prot., datë 06.03.2025 dhe nr. 205/6 prot., datë 28.03.2025, Komisioneri kërkoi nga pala ankuese plotësimin e ankesës me informacionin e nevojshëm për kryerjen e hetimit, konkretisht përkthimin në gjuhën shqipe të intervistës ku pretendohet se është përdorur termi i pretenduar si diskriminues. Pala ankuese, nuk e depozitoi informacionin e nevojshëm që do ti mundësonte Komisionerit vijim e procesurës së hetimit të pretendimit të ngritur në ankesë, pavarësisht kërkesave të përsëritura për plotësimin e ankesës.

Sa më sipër dhe bazuar në nenin 33, pika 4, të LMD, ku përcaktohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: ç) nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;”*, Komisioneri vlerëson se ankesa objekt shqyrtimi nuk mund të pranohet pasi nuk ka informacion

të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/b, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës me nr. 53 Regj., datë 28.02.2025, të subjektit ankues Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku:	Etnia
Fusha:	Gjuhë urrejtje
Lloji i vendimit:	Mospranim